



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

Legjislatura V  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit  
P-079

Prishtinë, më 19 dhjetor 2016, në orën 12:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 DHJETOR 2016**

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,  
Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe  
Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

\* \* \*

### **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 15 dhe 17 nëntor dhe 6 më dhjetor 2016**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 15 dhe 17 nëntor dhe më 6 dhjetor 2016.

### **2. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të 40 deputetëve të Kuvendit për seancë të jashtëzakonshme**

Kryetari i GP të PDK-së, z. Zenun Pajaziti, i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e 40 deputetëve të Kuvendit për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme me këtë rend dite:

#### *1. Debat parlamentar lidhur me rastin “Astrit Dehari”.*

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e lartshënuar.

Për kërkesën e 40 deputetëve të Kuvendit për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme diskutuan: Ismet Beqiri, Aida Dërguti, Pal Lekaj, Valdete Bajrami dhe Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të martën, më 20 dhjetor 2016, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. Debat parlamentar lidhur me rastin “Astrit Dehari”, sipas kërkesës së 40 deputetëve nënshkrues

### **3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryetari i njoftoi anëtarët e pranishëm me pikat e papërfunduara nga seancat e kaluara të mbajtura më 28 tetor dhe më 17 nëntor, më 30 nëntor dhe 1 më dhjetor 2016.

Kryesia, pasi diskutoi për pikat e papërfunduara nga seancat e kaluara, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit t'i vazhdojë punimet më 20 dhjetor 2016, pas përfundimit të seancës së jashtëzakonshme, me këtë:

#### **Rend dite**

- 1. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie,*
- 2. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga tetë deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës,*
- 3. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriut-Ukelli, mbështetur edhe nga nëntë deputet tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.*
- 5. Votimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim.*

#### **Përgatitjet për seancë të re**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 22 dhjetor 2016, në orën 10:00, me këtë:

#### **Rend dite**

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore,*
- 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168,*
- 8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,*
- 9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158,*
- 10. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë tjerë lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.*

\* \* \*

#### **4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

*1. Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Kosovës për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

#### **Përfundim**

Kërkohej nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione që në pajtim me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë peticionin e qytetarëve për zbardhjen e rastit të Astrit Dehari.

*2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria “subvencione dhe transfere”, miratuar me 6 dhjetor 2016*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria “subvencione dhe transfere”, mori këtë:

#### **Vendim**

1. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria “subvencione dhe transfere”, në nenin 4, paragrafët: 2, 3, 4 dhe 5.

2. Ndryshimi i Rregullores hyn në fuqi ditën e miratimit.

*3. Marrëveshja e Mirëbesimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe USAID-it*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **Vendim**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës participon me mjete financiare në shumë prej 20 000 (njëzet mijë) euro për realizimin e Marrëveshjes për llogari të mirëbesimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe USAID-it.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike “subvencione dhe transfere”.

*4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA, prej 29 janar - 4 shkurt 2017*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## **Vendim**

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Adem Grabovci, Aida Dërguti, Slobodan Petroviqi, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ganimete Musliu, Besim Beqaj dhe Haxhi Shala u lejohet pjesëmarrja në ceremoninë e 65-të “Lutjet e Mëngjesit”, në Uashington DC, SHBA, prej 29 janar - 4 shkurt 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, pjesëmarrjes (250\$ për person) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*5. Kërkesa e Radiotelevizionit të Kosovës për krijimin e kushteve për fillimin e hapjes së kanalit parlamentar*

Kryesia e shtyu kërkesën e lartshënuar për shqyrtim për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

*6. Kërkesa e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## **Vendim**

Miratohet kërkesa e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës për mbështetje financiare në shumën prej 2 583 (dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tri) euro për mbulimin e shpenzimeve për botimin e 100 ekzemplarëve të Doracakut në shkrimin brail.

*7. Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe të Viktimave Civile të Luftës për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## **Vendim**

Miratohet kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe të Viktimave Civile të Luftës për mbështetje financiare në shumën prej 2 000 (dy mijë) euro për t'i ndihmuar anëtarët e saj, të cilët përballen me kushte të vështira ekonomike të jetesës.

*8. Kërkesa e Organizatës për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## **Vendim**

Miratohet kërkesa e Organizatës për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP) për mbështetje financiare në shumën prej 700 (shtatëqind) euro për të organizuar festën e fund vitit për fëmijët pa kujdes prindëror.

*9. Njoftimi i dy (2) nënkryetarëve të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në punimet e Sesionit vjetor të 62-të të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Stamboll (Turqi), prej 19 - 21 nëntor 2016*

Kryesia u njoftua me raportin e dy (2) nënkryetarëve të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Slobodan Petroviq, lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në punimet e Sesionit vjetor të 62-të të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, të cilat janë mbajtur në Stamboll (Turqi), prej 19 - 21 nëntor 2016.

*10. Kompensimi i të punësuarve në Kuvendin e Republikës së Kosovës*

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, e konfirmoi Vendimin nr. 05-V-462, datë 14 dhjetor 2016, për kompensimin e të punësuarve në Kuvendin e Republikës për angazhim të shtuar jashtë orarit të punës në mbështetje të trupave punues të Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*